Tregjet e punës po ndryshojnë vazhdimisht dhe disa nga faktorët nxitës të këtij ndryshimi janë ri-formatimi i përbërjes së forcës së punës, lufta për tërheqjen e talenteve, përparimet e shpejta teknologjike rritja e efikasitetit nga pikëpamja e kostove dhe sigurisht ndryshimet në sjelljen e konsumatorëve. Përparimet teknologjike janë duke ndikuar në mënyrë thelbësore rolet e punës, mënyrën si kryhet puna dhe ku, e për rrjedhojë edhe aftësitë që kërkohen.

Pyetësori ka treguar se pjesa më e madhe e bizneseve të pyetura e kanë vendosur fokusin tek menaxhimi i njohurive krijimi dhe ruajtja e informacionit për një botë të ndërlidhur, kapitali njerëzor, siguria dhe mireqenia e punonjësve,

Duke i konsideruar njerëzit dhe teknologjinë si ADN e një kompanie me të cilin ngre qellimin potencialin dhe pespektiven, pyetësori ka hedhur dritë mbi mënyrën se si menaxherët e kompanive mendojnë për zhvillimin e fuqisë njerëzore dhe investimin në teknologji. Raporti i tren-



Trendet e Kapitalit Njerëzor në Shqipëri, 2020 (2021)
Ndërmarrja Sociale në Veprim
Paradoksi si një formë zhvillimi
Menaxhimi i Njohurive



deve të Kapitalit Njerëzor për vitin 2020 lidhet ngushtë me rolin e ndërmarrjeve sociale, koncepti i cili në rastin e Shqipërisë u prezantua për herë të parë në raportin e rezultateve të këtij vrojtimi mbi trendet e kapitalit njerëzor për vitin 2019. Ndërmarrja sociale është një organizatë, misioni i së cilës kombinon rritjen e të ardhurave dhe fitimit me kujdesin ndaj mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm ku ajo operon. Titulli i raportit global të Trendeve të Kapitalit Njerëzor për 2020 është "Ndërmarrja sociale në veprim: Paradoksi si një formë zhvillimi". Fuqia e ndërmarrjes sociale qëndron në aftësinë e saj për të sjellë

një fokus njerëzor në gjithçka që prek, duke i fuqizuar njerëzit që të punojnë në mënyrë produktive me teknologjinë për të krijuar vlera të qëndrueshme për veten, kompaninë dhe shoqërinë në përgjithësi.

Njerëzit dhe teknologjia janë dy elementë kyç të cilët ndikojnë sot në sukses-


sin e një kompanie. Megjithatë, sot po evidentohet se zhvillimi teknologjik në vendet e zhvilluara po rezultojnë në shtim të roleve të reja të punës se sa në automatizim dhe zëvendësim. Ndërkohë që punët e mërzitshme rutinë (punët "dorës") po zëvendësohen nga teknologjia, punët që kërkojnë aftësitë konjitive (njohëse) të njeriut dhe me sfiduese (punët e "mendjes") po njohin rritje. Përveç kësaj, zhvillimi teknologjik duket se po rrit nevojën për role pune më ndërpersonale dhe krijues të bazuara në aftësi specifike njerëzore si kreativiteti, shërbimi ndaj klientit, përkujdesja ndaj të tjerëve dhe bashkëpunimi.

Për të qenë një ndërmarrje sociale, tre janë atributet që një organizatë duhet të ketë:

QËLLIMI: Një organizatë që jo vetëm e tregon qëllimin e saj, por e përfshin kuptimin dhe zbatimin e saj çdo ditë në çdo aspekt të punës;

POTENCIALI: Një organizatë që është krijuar dhe organizuar për të maksimizuar atë që njerëzit janë të aftë të mendojnë, krijojnë dhe bëjnë në një botë të automatizuar;

PERSPEKTIVA: Një organizatë që inkurajon dhe përqafon orientimin drejt të ardhmes, duke kërkuar jo vetëm se çfarë duhet optimizuar sot, por si të krijojë vlerë nesër.



AmCham and AIMS International Albania explain

'Needs in developing and retraining the workforce under the new normal'

COVID-19 has had major effects on businesses, and human resources are one of the departments that have clearly felt the impact. As services, production and customer relationships are being reshaped to adapt to a new reality, HR departments are playing a fundamental role in re-shaping the workforce and adapting its skills for the new conditions under which businesses operate.

To deal with these issues, the American Chamber of Commerce in Albania, working together with AIMS International Albania and Kosovo, organized a webinar titled "Needs in developing and retraining the workforce under the new normal." The online seminar helped AmCham members receive updated information on new trends and developments in human resources -- ranging from the skills employees should have to the application of development programs for the workforce to the balance between professional and personal lives during the pandemic.

Monika Farka, Managing Partner of AIMS International Albania and Kosovo, provided a summary of data that came out of a questionnaire organized in De-

cember 2020 and which shed light on the situation of businesses during the pandemic and their relations with the workforce.

The fast pace of business and technological changes during the pandemic placed training programs at the center of focus for all of Albania's industries. To support their businesses, HR departments are mobilizing internal talent and at the same time are developing retrain-



NECESSARY MANAGERIAL SKILLS DURING THE PANDEMIC

Adaptability / Sustainability

Communication / Collaboration

Planning and organizing

Digital skills

ing programs for their current staff. Not all industries can react equally, and it seems that the banking and financial systems sector has led in its developing and retraining of the workforce, followed by the retail and tourism sectors.

The most important skills needed to grow during the pandemic for experienced managers are adaptability, resilience, communication and collaboration. For recent graduates working as

managers, the most important skills are customer focus and team spirit.

Trends have shown that remote work will continue. More than half of the companies surveyed are embracing a hybrid work style while a minority have moved entirely into remote work. The survey also points out that most businesses in Albania have invested in digital transformations. While some sectors had begun to adapt to new technological trends before the pandemic, such as banking or IT entities, for others it seems that the pandemic has made investing in digital technologies an imperative of the time.

The questionnaire also gathered the opinion of businesses regarding the impact of the pandemic on their operations. More than a third of businesses surveyed said they were not impacted by COVID-19. This is clearly reflected in the workforce, with 43 percent claiming no changes in their workforce. Those most affected by the COVID-19 situation are tourism sector employees. The reduction of the labor force in that sector was the largest, with approximately 72 percent.



Dhoma Amerikane e Tregtisë dhe AIMS International Albania Flasin për

"Nevojat për zhvillimin dhe ri-aftësimin e fuqisë punëtore në normalitetin e ri"

COVID-19 tashmë i ka të provuara efektet mbi biznesin, dhe burimet njerëzore janë një nga departamentet që vuajnë vullën e tij. Ndërsa shërbimet, prodhimi, marrëdhëniet me klientin janë duke u ridimensionuar për tju përshtatur një realiteti të ri, burimet njerëzore po luajnë një rol themelor në ridimensionimin e fuqisë punëtore dhe përshtatjen e aftësive të tyre për kushtet e reja në të cilat zhvillohet biznesi.

Dhoma Amerikane e Tregtisë në bashkëpunim me AIMS International Albania & Kosovo, kanë organizuar web-binarin "Nevojat për zhvillimin dhe ri-aftësimin e fuqisë punëtore në normalitetin e ri" gjatë të cilit anëtarët e Dhomës Amerikane kanë marrë një informacion të përditësuar mbi trendet e reja të zhvillimeve në burimet njerëzore nga aftësitë që duhet të kenë punonjësit, aplikimi i programeve zhvilluese për forcën punëtore deri tek balancimi i jetës profesionale dhe personale gjatë pandemisë.

Monika Farka, Managing Partner e AIMS International Albania & Kosovo ka bërë një rezymë të të dhënave që dolën nga një pyetësori i organizuar në Dhjetor

të 2020 dhe që hodhi dritë mbi situatën e bizneseve gjatë pandemisë dhe raportet e tyre me fuqinë punëtore.

Ritmi i shpejtë i biznesit dhe ndryshimet teknologjike gjatë pandemisë, kanë vendosur programe aftësimi në qendër të të gjitha industrive në Shqipëri. Për të mbështetur biznesin e tyre, burimet njerëzore janë duke mobilizuar talentin e brendshëm dhe në të njëjtën kohë po zhvillojnë programe



AFTËSITË E NEVOJSHME MENAXHERIALE GJATË PANDEMISË:

Përshtatshmëria / Qëndrueshmëri

Komunikimi / Bashkëpunimi

Planifikimi dhe organizimi

Aftësi Dixhitale

riaftësimi për stafet aktuale. Jo të gjitha industritë reagojnë njëjloj, dhe duket se sistemi bankar dhe ai financiar ju është dashur të punojnë për të zhvilluar dhe riaftësuar forcën punëtore e ndjekur nga sektori i shitjes me pakicë dhe turizmi.

Aftësitë më të rëndësishme të nevojshme që duheshin zhvilluar gjatë pandemisë për menaxherët me përvojë janë përshtatshmëria, qëndrueshmëria dhe komunikimi dhe

bashkëpunimi. Për menaxherët e rinj niveli i diplomuar, aftësitë më të rëndësishme janë fokusi i klientit dhe fryma e ekipit. Trendet kanë treguar se puna në distancë do të vazhdojë. Më shumë se gjysma e kompanive të pyetura po përqafojnë një hibrid stili të punës ndërkohë që një pakicë janë duke punuar tërësisht në distancë. Bien në sy nga anketimi se shumica e bizneseve në Shqipëri kanë investuar në transformimet dixhitale. Ndërsa disa sektorë kishin filluar përshtatjen me trendet e reja teknologjike përpara pandemisë, si sistemi bankar apo IT, për të tjerët duket se pandemia e ka kthyer në imperative të kohës investimin në teknologjitë dixhitale.

Pyetësori ka konfiguruar mendimin e bizneseve edhe për sa i takon ndikimit të aktivitetit nga pandemia. Më shumë se një e treta e bizneseve të anketuara nuk kishte asnjë ndikim nga Covid 19. Kjo është reflektuar qartë në fuqinë punëtore, ku 43% pretenduan nuk kanë ndryshime në fuqinë e tyre të punës. Ata që janë ndikuar më shumë nga situata e Covid 19 janë punonjësit e sektorit të turizmit. Reduktimi i fuqisë punëtore në këtë sektor ka vlerën më të lartë afërsisht 72%.

Members quotes



Edlira Merka

**CEO BALFIN GROUP,
ZV. PRESIDENTE
AMCHAM ALBANIA**

Përpjekjet tona duhet të jenë të vendosura dhe të qarta, që masat kufizuese mos të jenë asnjëherë të tilla, sa që të mund të sjellin një kolaps financiar dhe të vendosin biznesin në kushte të pariparueshme. Zhvillimi ekonomik është jetik dhe masat shtrënguese duhet të jenë në proporcion me pandeminë dhe pasojat e saj, të cilat duhen vlerësuar hap pas hapi në varësi të zhvillimeve të situatës. Ne jemi duke monitoruar masat ndaj biznesit në vendin tonë, në rajon por edhe më gjerë, në mënyrë që të reagojmë me efikasitet në dobi të biznesit dhe qindra mijëra të jetësuarve në të. Të jetuarit dhe të bërit biznes janë dy anët e së njëjtës monedhë, të cilat duhet të ecin krah për krah njëra-tjetrës dhe në asnjë rast njëra të mos çënojë tjetrën”



Bledar Beta

**PHILIP MORRIS
ALBANIA BOARD
MEMBER, AMCHAM
ALBANIA**

“We all witnessed a massive disruption to our lives this year. Over few months, we deeply reshaped what we had established for many years: our ways of thinking and interacting with each other, our consumer behaviors and our ways of doing business. Any business plan, no matter how carefully thought, might quickly turn into a business trap if it fails to account for this disruptive environment. As we head to a new normality, the future success of many businesses will depend on their organizational agility to rapidly transform their business models and embrace the changes it will bring.”



Rodem Hajaj

**KRYETAR I
KOMITETIT TË
PUNËS DHE ETIKËS
NË AMCHAM**

Komiteti i Etikës dhe Punës synon ndërgjegjësimin mbi nevojën e etikës në biznes për përmirësimin e klimës së biznesit. Ne mbështesim anëtarët tanë në çështjet e menaxhimit të kapitalit njerëzor për sfidat që ata hasin sipas trendeve zhvillimore në vend dhe më gjerë.



Alketa Ruzici

**KRYETARE E
KOMITETIT TË
TAKSAVE DHE,
DOGANAVE NË
AMCHAM**

Në Komitetin e Taksave dhe Doganave ne jo vetëm identifikojmë problemin por ofrojmë edhe zgjidhje bazuar në eksperiencën tonë dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.



AmCham and Facilization discuss

Automation and digitization of business processes

The American Chamber of Commerce in Albania, in cooperation with Facilization, offered members of the AmCham community a workshop on “Automation and Digitization of Marketing, Sales and Customer Service.”

The adverse effects of the pandemic have led to the need to digitize many business processes to remain competitive in the market. For this reason, this workshop was interesting and kept participating members engaged.

At the workshop, Facilization General Manager Gjergji Guri and his staff discussed with members the opportunities and challenges related to the digitization of marketing, sales and customer support services for medium and large enterprises. The training focused on explaining best practices and technological solutions for business process management and various customer relationship management tools that can be easily used by businesses in many

sectors of the economy.

The workshop presenters also provided a summary of the obstacles and challenges faced by different businesses and the available opportunities and digital tools.

Mr. Guri explained to AmCham members what it means to implement a digital transformation of a company, what processes undergo digitization and how a company can adapt to rapid change and reshape its customer relationships.

Companies that implement the digitization process often face lack of knowledge, unskilled staff and, above all, a low number of opportunities to adopt digital changes in the business.

Speaking about the digital transformation, Mr. Guri explained that the digitization of processes enables a business to create a new type of flow in its processes and to respond quickly and on time to the needs of clients and as a result, remain competitive in the marketplace.

AmCham dhe Facilization flasin për:

Automatizim dhe digjitalizim të proceseve të biznesit

Dhoma Amerikane e Tregtisë në bashkëpunim me kompaninë Facilization i ka ofruar anëtarëve të komunitetit të saj workshop-in me temën “Automatizimi dhe Digjitalizimi i marketingut, shitjeve dhe shërbimit ndaj klientit”

Situata e pandemisë dhe orientimi i biznesit on line dhe digjitalizimi i proceseve për ti bërë konkurrues në treg, duket se ka nxitur interesin e lartë të anëtarëve të AmCham.

Gjatë workshopit Gjergji Guri, drejtues i Facilization, dhe stafi i tij, kanë diskutuar me anëtarët mundësitë dhe sfidat që lidhen me digjitalizimin e marketingut, shitjeve dhe shërbimeve të mbështetjes së klientëve në ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha. Trajnimi ka patur në fokus shpjegimin e praktikave më të mira dhe zgjidhjet teknologjike të specializuara në fushën e menaxhimit të procesit të biznesit dhe mjetet e ndryshme të menaxhimit të marrëdhënive me klientët që mund të përdoren lehtësisht

në shumë sektorë të ekonomisë dhe biznesit privat.

Gjatë takimit lektorët kanë bërë një rezumë të pengesave dhe sfidave me të cilat përballen biznese të ndryshme, dhe cilat janë oportunitetet e digjitalizimit të biznesit të tyre. Gjergji Guri ka shpjeguar për anëtarët se çfarë do të thotë të besh një transformim digjital për kompaninë tënde, cilat janë proceset që i nënshtrohen digjitalizimit dhe si kompania i përshtatet ndryshimeve të shpejta dhe rridhshmeve të marrëdhënies së saj me klientin. Kompanitë që po bëhen pjesë e proceseve digjitalizuese, shpesh përballen me mungesën e njohurive stafin e kualifikuar dhe mbi të gjitha me mundësi të ulta të adoptimit të biznesit të tyre me ndryshimet digjitale.

Duke folur për transformimin digjital, z. Guri, ka shpjeguar se digjitalizimi, i jep mundësi biznesit të krijojë një rrjedhë të re të proceseve të tyre si dhe ti përgjigjet shpejt e në kohë nevojave të klientit duke mbetur konkurrues në treg.



COMMITTEES IN ACTION

AmCham Agenda 2021: Serving the community of member businesses

AmCham committees have updated their agendas -- adapting themes and activities to the new reality caused by the pandemic and the economic hardships it has brought.

A new trend of doing business that aims to digitize all processes, legislation that evolves and approximates to EU laws, new forms of tax legislation, regulatory systems in development -- all these have formed the basis of the work of committees which have offered members a wide range of services from training sessions to lobbying to meet-

ings with senior officials.

The AmCham Board of Directors has drafted the policies on which the Chamber has operated during this difficult year, translating the business needs and new environment into events and developing fair and constructive relations with all partners.

Remote work has made it harder to do business and it has not been easy

for many companies to continue operations and stay productive in the market as well as keep all their employees. The situation has made it imperative to organize training sessions that upgrade the skills of employees and explain the latest trends. Meanwhile, the tax system is undergoing changes for several business categories, leaving more tax-free room for small businesses and bringing incentives for big businesses. All of these, along with new fiscalization methods, are themes built into an ambitious agenda at AmCham.

Working toward improving the business climate has been no less important, and all committees have provided a detailed analysis and made relevant recommendations on the matter.

TAX AND CUSTOMS COMMITTEE

Meetings with customs and tax institutions and open discussion with the leading officials continued to be the focus of the AmCham Tax and Customs Committee. In 2021, the Committee's key focus is on providing information on legislation changes affecting the tax system as well as explaining new methods of fiscalization and registration of small businesses exempt from VAT. The Committee has also focused on long-term developments such as the approximation of Albanian laws with those of the European Union. It is also planning to hold meetings with the officials responsible for economics and finance emerging from the 2021 general elections.

LABOR AND ETHICS COMMITTEE

Ethics in business and the implementation of labor relations that reflect current trends continued to remain in the spotlight of the Labor and Ethics Committee. As ethics conventions evolve year after year -- internships, HR relationships as part of doing business as well as the laws governing labor relations have become interesting topics of meetings and training sessions provided by the Committee. The new trend of working from home, meanwhile, has led to wide-ranging discussions among members and experts who are bringing the best models of how remote work can be managed.

REGULATORY, LEGAL AND IPR COMMITTEE

A developing economy also sees changes to its legislation and rules. Meeting with officials of agencies and institutions that lead the implementation of these rules and guide the work of businesses has been the key focus of the Regulatory, Legal and IPR Committee. Moreover, the Committee has played a major role in providing information to members on new government requirements on businesses, including those relating to the register of beneficiary owners. Meanwhile, the Committee has also been involved in bringing a positive impact to the investment climate and an expert team has been created by AmCham to work toward that goal.

INVESTMENT AND TRADE COMMITTEE

has played a major role in creating the Investment Agenda, moving forward on fundamental issues that concern businesses as part of the investment climate in the country. This year will see increased attention on the Agenda of Regional Meetings with other AmChams in the region and joint work, in the framework of increasing cooperation among the governments of the Western Balkans. The committee will have the opportunity to bring members together at the same table with AIDA leaders in 2021 to talk specifically about opportunities for cooperation.

DIGITAL BUSINESS COMMITTEE

In an era when digitalization is becoming a necessity, the Digital Business Committee has a lot to do. In 2021, the Committee will continue its work to provide businesses with the benefits that come from e-signature while working to bring to small businesses the expertise needed to digitize key work processes. This year, the Committee plans to have meetings with international and EU institutions to seek the involvement of the business community in partnerships on various projects that focus on innovation.

KOMITETET NË VEPRIM

Axhenda e 2021 në AmCham në shërbim të komunitetit të anëtarëve

Komitetet në Dhomën Amerikane kanë përditësuar axhendat e tyre duke përshtatur temat dhe aktivitetet, drejt një realiteti të ri të shkaktuar nga pandemia dhe e vëshirësive ekonomike që solli.

Një trend i ri i të bërit biznes që synon digjitalizimin e të gjitha proceseve, legjislacione që evolojnë dhe përafrohen me BE-në, forma të reja të legjislacionit tatimor, sisteme rregullatore në zhvillim, të gjitha këto kanë përbërë bazën e punës së komiteteve të cilat i kanë ofruar anëtarëve një diapazon të gjerë nga trajnimet lobimet e deri tek takime me zyrtarë të lartë.

Bordi i Drejtorëve ka hartuar politikat mbi të cilat Dhoma ka funksionuar gjatë këtij viti të vështirë duke përkthyer nevojat dhe situatën e biznesit në evente dhe në zhvillimin e raportet të drejta dhe konstruktive me të gjithë partnerët e saj.

Puna në distancë e ka bërë të vështirë sipërmarrjen dhe nuk ka qenë e lehtë për ta që të vazhdojnë aktivitetin duke qëndruar produktiv në treg dhe duke

mbajtur numrin e punonjësve. Kjo e ka bërë imperative të kohës organizimin e trajnimeve që zhvillojnë aftësitë e punonjësve por dhe shpjegon tendencat e fundit.

Ndërkaq sistemi tatimor, sjell risi për kategoritë e biznesit duke i lënë një hapësirë më të madhe dhe pa taksa biznesit të vogël dhe duke sjellë incentiva për biznesin e madh. Të gjitha këto së bashku me teknika të reja të fiskalizimit kanë qënë tema, që kanë ndërtuar një axhendë ambicioze në AmCham.

Jo më pak të rëndësishme kanë qënë zhvillimet për të sjellë një impuls pozitiv në klimën e biznesit dhe puna e të gjitha komiteteve për të bërë një analizë të detajuar dhe sugjeruar rekomandimet përkatëse.



KOMITETI I TAKSAVE DHE DOGANAVE

Takimet me institucionet e doganave dhe tatimeve dhe diskutimi i hapur me titullarët e tyre kanë vazhduar të jenë në fokus të Komitetit të Taksave dhe Doganave. Gjatë 2021 një element i fortë që vjen prej Komitetit të Taksave është informimi mbi ndryshimet ligjore në sistemin tatimor, si dhe shpjegimi i teknikave të reja të fiskalizimit dhe regjistrimit të biznesit të vogël të përjashtuar nga TVSH-ja. Jo më pak kujdes ka treguar ky Komitet dhe kur vjen fjala për zhvillime afatgjatë si përafrimi ligjor me ato të BE-së apo takime me zyrtarët e rinj, përgjegjës për ekonominë dhe financat, që do të dalin nga zgjedhjet e 2021.



KOMITETI I PUNËS DHE ETIKËS

Etika në biznes dhe zhvillimi i marrëdhënieve të punës që reflektojnë të gjitha trendet e kohës, ka vazhduar të mbetet në qendër të vëmendjes së Komitetit të Punës dhe Etikës në biznes. Ndërsa konferencat mbi etikën evolojnë nga viti në vit, intershipet, marrëdhëniet e HR në zhvillimin e biznesit si dhe ligjet që rregullojnë marrëdhëniet e punës, janë bërë tema interesante të takimeve dhe trajnimeve të ofruara nga ky Komitet. Trendi i ri punës nga shtëpia ndërkaq, është kthyer në një diskutim të gjerë mes anëtarëve dhe ekspertëve që janë duke sjellë modelet më të mira se si mund të menaxhohet puna në distancë.



KOMITETI RREGULLATOR, LIGJEVE DHE IPR

Një ekonomi që zhvillohet ka ndryshime dhe në legjislacionin dhe rregullat e veta. Të takohesh me zyrtarë të agjencive dhe institucioneve që mbajnë flamurin në zbatimin e këtyre rregullave dhe orientojnë punën e biznesit, ka qënë tema më e preferuar e Komitetit Rregullator dhe Ligjeve, Përtej kësaj Komiteti ka luajtur një rol të madh në trajnimin e anëtarëve me kërkesa të reja që vijnë nga qeveria dhe që kanë të bëjnë me regjistrin e pronarëve përfitues. Ndërkohë puna për të sjellë një impakt pozitiv në klimën investimeve, ka përfshirë edhe këtë Komitet dhe ekspertët e saj në skuadrën e krijuar nga AmCham për këtë qëllim.



KOMITETI I TREGTISË DHE INVESTIMEVE

Komiteti i Tregtisë dhe Investimeve ka patur një rol të madh në krijimin e Agendës së Investimeve dhe impulseve që ka sjellë për çështjet themelore që shqetësojnë klimën e investimeve të biznesit. Një vëmendje e shtuar gjatë këtij viti do ti jepet edhe Axhendës së takimeve Rajonale me Dhomat e tjera Amerikane në Rajon dhe punës së përbashkët, në kuadër dhe të bashkëpunimeve të Ballkanit Perëndimor. Komiteti i Investimeve do të ketë mundësi të ulë në tryezë me anëtarët gjatë 2021, titullarë të AIDA për të folur konkretisht mbi mundësitë bashkëpunimit.



KOMITETI I BIZNESIT DIGJITAL

Në një epokë ku dixhitalizimi po kthehet në domosdoshmëri, Komiteti i Biznesit Dixhital ka shumë për të bërë. Gjatë 2021 ky Komitet do të vazhdojë punën për ti ofruar bizneseve lehtësitë që vijnë nga e-signature ndërkohë që po punohet për të sjellë për bizneset e vogla ekspertizën e nevojshme për dixhitalizimin e proceseve kryesore të punës. Gjatë 2021 ky Komitet do të ketë takime me institucione ndërkombëtare dhe ato të EU-së për të kërkuar përfshirjen e komunitetit të biznesit në një partnershipi në kuadër të projekteve të ndryshme që kanë në fokus inovacionin.



11 BUSINESS ORGANIZATIONS WRITE TO MINISTER DENAJ TO ASK FOR DEADLINE EXTENSION

Beneficiary owner registration creates problems for NGOs and businesses

The lobbying efforts of 11 business organizations to extend the legal deadline for registering the beneficial owners has been successful. The Government has extended the registration deadline to June 30, 2021, in response to the business community's concerns on the insufficient time and difficulties in providing the necessary documentation.

"In order to fulfill the legal obligations provided in the law for registering the beneficiary owners, as well as to carry out a process as efficient and comprehensive as possible, considering that the deadline for fulfilling this obligation until March 31 was not sufficient, were considered the necessary reasons for the extension of the term"- announced the Ministry of Finance.

With the changes made to this normative draft act, in response to the business requirements, it is estimated that in case of changes in the data of the beneficial owners of reporting entities, this registration should be completed within 90 days from the date of the actual change.

Business organizations have asked Minister Denaj to take into account the problems that businesses and NGOs are facing with the system, providing the necessary documentation and implementing other laws like the one on electronic signatures. As a result, they are seeking to push the deadline from March 31 to June 30. That extension would give NGOs and businesses time to complete the necessary documentation. It would also give time to the National Agency for an Information Society (AKSHI) and the Tax Administration to improve the online platform to the needed level of interactivity.

Non-profit organizations have argued

that their registration in the Register of Beneficiary Owners in e-Albania cannot be done the same way as that of commercial companies as their activity is based on different parameters. In the case of NGOs, the meaning of beneficial owner cannot be directly applied as NGOs can be run by members, a board, an executive director or a secretary general and the registration should be based on the situation of the NGOs.

Moreover NIPT numbers issued to NGO administrators are not recognized by the e-Albania system, which makes it even more difficult to register these organizations. Also, opening an account in e-Albania, which is administered by AKSHI, has led to other difficulties as the system does not have the data of the administra-

tor or legal representatives -- like general secretaries or executive directors -- which are then not recognized as legal representatives by the system despite the fact that in some cases they appear as such and are registered in court.

NGOs need to update the necessary documentation, which presents its difficulties in collecting, as there are organizations like foreign chambers of commerce that have a considerable number of members. Combined with the lack of full-time in-office staff due to pandemic conditions, the situation becomes even more difficult. Also, these foreign organizations can have foreign beneficial owners who then have difficulty in obtaining the necessary documentation from the countries of origin and the conversion of the documentation according to the Albanian legislation takes time.

Just as problematic are difficulties encountered in business registration, above all difficulties that come from the online platform and the system which, although has been in operation since the end of January, does not work with proper efficiency. The situation is also difficult for those foreign investors who have to provide the necessary documentation and fulfill the obligations in a very short time. Large corporations that are public entities in other countries also face a similar situation.

Another problem identified by businesses is that administrators who are foreign nationals receive the registration link by email but cannot receive the relevant code for activating the link which is sent to a phone number.

11 SHOQATA BIZNESI I SHKRUAJNË MINISTRES DENAJ PËR SHTYRJEN E AFATIT

Regjistrimi i pronarit përfitues i hap probleme OJF-ve dhe Biznesit

Ka rezultuar i suksesshëm lobimi i 11 organizatave të biznesit, për të shtyrë afatin ligjor për regjistrimin e pronarëve përfitues. Qeveria ka shtyrë deri me 30 qershor 2021 afatin e regjistrimit, duke reaguar pozitivisht përballë argumenteve që listoi komuniteti i biznesit mbi pamjaftueshmërinë e kohës dhe problematikat në sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm.

"Me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore të parashikuara në ligjin për regjistrimin e pronarëve përfitues, si edhe për të realizuar një proces sa më efikas dhe gjithëpërfshirës, duke konsideruar që afati i përmbushjes së këtij detyrimi deri më 31 mars nuk ishte i mjaftueshëm, u konsideruan arsyet e nevojshme për zgjatjen e afatit" – bëri me dije Ministria e Financave.

Me ndryshimet e këtij projektakti normativ, në përgjigje edhe të kërkesave të biznesit, është vlerësuar që në rastin e ndryshimeve të të dhënave të pronarëve përfitues të subjekteve raportuese, ky regjistrim të bëhet brenda 90 ditëve nga data e ndodhjes së ndryshimit Faktik.

Shoqata të biznesit i kanë kërkuar Ministres Denaj të marrë në konsideratë problematikat me të cilat biznesi por dhe OJF -të po hasin me sistemin, me sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe me zbatimin e disa ligjeve sic janë nënshkrimi elektronik, për të cilat detyrohen të kërkojnë shtyrjen e afatit nga 31 mars në 30 qershor. Kjo shtyrje e afatit do t'u jepte kohë OJF -ve dhe bizneseve të plotësonin dokumentacionin e nevojshëm ashtu sikurse edhe AKSHI-t dhe Administratës Tatimore, për të përmirësuar platformën në nivelet e nevojshme.

Organizatave jofitimprurëse kanë argumentuar se regjistrimi i tyre në Regjistrin e Pronarëve Përfitues në e-albania, nuk mund të jetë si ai shoqërive tregtare pasi ka specifika të tjera të organizimit të veprimitarisë. Në rastin e OJF kuptimi i pronarit përfitues nuk gjen aplikim të drejtë për drejtë pasi OJF mund të jene me apo anëtarësi, me bord apo me Drejtor Ekzekutiv apo Sekretar të Përgjithshëm dhe nxjerrja e akteve të regjistrimit duhet të mbështetet dhe në pozitat e OJF-ve.

Gjithashtu numrat e NIPT-it apo administratorët e OJF nuk janë të njohur nga sistemi e-albania çfarë e bën akoma edhe më të vështirë regjistrimin e shoqatës.

Gjithashtu çelja e një llogarie në e-albania që administrohet nga AKSHI ka shkakuar një tjetër vështirësi pasi sistemi nuk i ka të dhënat e administratorit apo përfaqësuesit ligjor dhe sekretarët e përgjithshëm apo drejtorët ekzekutiv nuk njihen si përfaqësues ligjorë nga sistemi pavarësisht



se në disa raste figurojnë si të tillë dhe të regjistruar në gjykatë.

OJF ju duhet të azhurnojnë dokumentacionin e nevojshëm i cili paraqet vështirësitë e veta për të mbledhur pasi ka organizime si Dhomat e Huaja të Tregtisë të cilat kanë një numër të konsiderueshëm anëtarësh. Kombinuar kjo edhe me mungesën e një stafi me kohë të plotë për shkak të kushteve të pandimisë, situata bëhet edhe më e vështirë. Gjithshtu këto shoqata të huaja, kanë pronarë përfitues të huaj të cilë kanë vështirësi për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm nga vëndet e origjinës dhe njëhësimi i dokumentacionit sipas legjislacionit shqiptar kërkon kohë.

Po kaq të argumentuara duken dhe vështirësitë që has për regjistrim biznesi i cili duhet mbi të gjitha të përballet me vështirësitë që vijnë nga platforma dhe sistemi të cilat edhe pse janë vënë në funksion që nga fundi i janarit, nuk janë në efencën e duhur. E vështirë është situata edhe për ata investitorë të huaj të cilët duhet të sigurojnë dokumentacionin e nevojshëm dhe përmbushjen e detyrimeve në një kohë mjaft të shkurtër. Në këtë kuadër janë edhe korporatat e mëdha të cilat janë ente publike në shtetet të tjera.

Një tjetër problematikë e evidentuar nga bizneset është se administratorët që janë shtetas të huaj e marrin linkun e regjistrimit me email por nuk arrijnë të marrin kodin përkatës për aktivizimin e linkut i cili dërgohet në numrin e telefonit.



AMCHAM COMMENTS ON THE REGISTRATION OF BENEFICIARY OWNERS

1 The 60-day deadline for the establishment of the Register of Beneficiary Owners is provided by law, specifically Article 15 of Law No. 112/2020. It stipulates that "reporting entities must register the data required by this law for the beneficiary owners no later than 60 calendar days from the creation of the register, according to the definition of point 2 of this article." While the creation of the register is to be done no later than Jan. 31, 2021.

So, the extension of this deadline through a Decision of the Council of Ministers (DCM) would be disputable, and it would be advisable for the extension to be done through a law change.

Alternatively, a regulation should be issued to stipulate that the register will be operational/effective on April 30, 2021, so that it gives entities a deadline of 60 days from that date -- i.e. June 30, 2021.

2 Regarding the second point of the draft DCM, in addition to point c) of chapter III, point c) of chapter III should be changed, as they list the same documents with the change that point c) is for the initial registration in the register and point c) is for recording changes of data in the register.

If this change is not made, it will mean that the validity of the documents will be 90 days for the initial registration of the last beneficiaries and meanwhile if there are changes, the documents must be no older than 30 days. This differentiation does not make sense.

3 To add another point in the draft DCM regarding the creation of the possibility of "suspension of the application" in case of lack of documents in the application.

Specifically, in Article 6, paragraph 4 of Law no. 112/2020 "On the register of beneficiary owners" as well as in DCM no. 1088, dated Dec. 24, 2020, to add the possibility of "suspension of application," in analogy with Law no. 9723,

dated May 3, 2007 "On business registration," as amended.

In article 56 of Law no. 9723, dated May 3, 2007, the rules provide for the "suspension of the application." In cases when after the verifications provided in Article 54 of that law, it turns out that the conditions for registration are not met, the relevant registration fees are not paid, there are unpaid administrative sanctions or the required registrations have not been completed, according to Article 46, the National Business Center (NBC) suspends the application and notifies the applicant in writing of the exact reason for the suspension, giving it a period of 21 calendar days to complete or rectify the elements that impede registration. The reason for the suspension is announced through a standard NBC form. If the applicant completes or corrects the elements that hinder the registration, within the deadline specified in point 1 of the article, the NBC is obliged to complete the registration within a period of 1 day from the date of completion or correction of documentation. In this case, the registration bears the date of submission of the first application.

This allows entities (as opposed to immediate refusal) to submit additional documents in support of their application, without having to start a new application that could have serious consequences, requiring the collection of documents from scratch (which requires additional time and comes with added cost for entities). It also reduces appeal procedures that may be initiated by entities in the event of an unfounded rejection of the application.

KOMENTET E DHOMES AMERIKANE PËR REGJISTRIMIN E PRONARËVE PËRFITUES

1 Afati 60 ditor nga Krijimi i Regjistrimit të Pronarëve Përfitues është i parashikuar në Ligj, konkretisht në nenin 15 të ligjit nr.112/2020 parashikohet se "subjektet raportuese duhet të regjistrojnë të dhenat e kerkuara nga ky ligj për pronaret përfitues jo më vonë se 60 dite kalendarike nga krijimi i regjistrimit, sipas përcaktimit të pikës 2 të këtij neni". Nderkohe që krijimi i regjistrimit bëhet jo më vonë se 31.01.2021.

Pra, shtyrja e këtij afati me VKM është e kontestueshme dhe do të ishte e keshillueshme që kjo shtyrje të bëhet me ligj.

Si alternative, duhet të dale një akt nenligjor që të përcaktojë se regjistri do të jetë operativ/efektiv më 30.04.2021, në mënyrë që subjektet të kenë deadline 60 dite nga kjo datë – pra 30.06.2021.

2 Në lidhje me pikën e dytë të projekt-VKM përveç pikës c) të kreut III, duhet të ndryshohet edhe pika c) e kreut III, pasi listojnë të njëjtat dokumenta me ndryshimin që pika c) është për regjistrimin fillestar në regjister dhe pika c) është për regjistrimin e ndryshimeve të të dhenave në regjister.

Nese nuk behet ky ndryshim, do të rezultojë që vlefshmeria e dokumentave do të jete 90 dite për regjistrimin fillestar të përfituesve të fundit dhe nderkohe nese ka ndryshime, dokumentat duhet të jene jo më të vjeter sesa 30 dite. Ky diferencim nuk ka kuptim.

3 Të shtohet një pikë tjetër në projekt-VKM në lidhje me krijimin e mundësisë së "pezullimit të aplikimit" në rast të mungesës së dokumentave në aplikim.

Konkretisht, në nenin 6, paragrafi 4 të ligjit nr. 112/2020 "Për regjistrimin e pronarëve përfitues" si dhe në VKM nr. 1088, datë 24.12.2020, të shtohet mundësia e "pezullimit të aplikimit", në analogji me ligjin nr. 9723, datë

03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

Në nenin 56 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 parashikohet "pezullimi i aplikimit" - Në rastet kur pas verifikimeve të parashikuara në nenin 54, të këtij ligji, rezultoni se nuk janë përmbytur kushtet për regjistrim, nuk janë paguar tarifat përkatëse të regjistrimit, ka sanksione administrative të papaguara apo nuk janë kryer regjistrimet e kërkuara, sipas nenit 46, QKB-ja pezullon aplikimin dhe e njofton aplikuesin me shkrim për shkakun e saktë të pezullimit, duke i dhënë një afat prej 21 ditësh kalendarike për plotësimin ose ndreqjen e elementeve që pengojnë regjistrimin. Njoftimi i shkakut të pezullimit bëhet nëpërmjet një formulari standard të QKB-së. Nëse aplikanti plotëson ose ndreq elementet që pengojnë regjistrimin, brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, QKB-ja është e detyruar të kryejë regjistrimin brenda një afati 1-ditor nga data e plotësimit ose ndreqjes së dokumentacionit. Në këtë rast, regjistrimi mban datën e paraqitjes së aplikimit të parë.

Kjo i jep mundësi subjekteve (ndryshe nga refuzimi i menjehershëm) që të paraqesin dokumenta shtesë në mbledhjet e aplikimit të tyre, pa u detyruar që të nisnin një aplikim të ri që mund të ketë pasojë të rënda, duke kërkuar mbledhjen e dokumentave nga e para (e cila kërkon kohë dhe kosto shtesë për subjektet). Gjithashtu redukton edhe procedurat e ankimit të cilat mund të fillojnë subjektet, në rast të një refuzimi të papabazuar të aplikimit.



Tirana Economic Forum - The Discussion between the President of AmCham in Albania, Mr. Enio Jaco and Mr. Damir Marusic, Resident Senior Fellow, Atlantic Council.

The US-Albania Relations on the Biden Era

AmCham President Enio Jaco: Skavica and Vloëra power plants will turn Albania into a regional energy hub. More investment opportunities available if reforms addressed

DAMIR MARUSIC: *One of the priorities of the Biden Administration seems to be to first and foremost patch things up with core European allies. Unfortunately, that has meant that for countries not yet in the EU, there is less attention that perhaps there should be.*

ENIO JACO: *What, in your opinion are Albania's top priorities with the Biden Administration?*

ENIO JACO: A single goal for US admin-

The President of the American Chamber of Commerce in Albania, Enio Jaco, discussed relations between Albania and the United States during the Biden Administration at the Tirana Economic Forum in a conversation with Atlantic Council Senior Fellow Damir Marusic. Mr. Jaco said that after two strategic projects -- the Skavica hydroelectric power plant and the Vloëra gas-powered power plant, American investments in Albania can become long-term and dominant if the right reforms take place.

He added that defense/security, democracy and business continue to be the three main priorities of the White House in terms of its policies in the Western Balkan countries, including Albania. Speaking specifically about the Biden Administration's priority on business development as it relates to Albania, Jaco said: "The Business priority is new. It typically means a stronger commercial U.S.-Albania connection, more US investments, more trade and so on. This is refreshing because it never before been raised at such a high policy level. And it has had surprisingly strong results in a short term. Last year Albania and the United States signed the most important economic agreement since the 1990s, an important Memorandum of Understanding, which includes building a major hydro-power project. And agreement with ExxonMobile to build a thermal power station for LNG (Liquid Natural Gas) is being finalized in just a few days." Describing these recent developments as among the most important in the economic relations between the two countries, Mr. Jaco emphasized the need to improve the business climate in general.

